



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

---

Datë: 5 mars 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 26 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 12, 14, 16 dhe nenit 23 paragrafi 2 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit si dhe Vendimin KPK/Nr.157/2025, të datës 03 mars 2025, shpall:

**SHPALLJE E BRENDSHME**

**Për plotësim me një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren**

1. Prokurorët e Shtetit duhet t'i plotësojnë kriteret për avancim në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren, si në vijim:
  - Të jetë prokuror me mandat të përhershëm;
  - Të ketë vlerësim të performancës të mjaftueshëm ose më të lartë.
  - Vlerësimi " I mjaftueshëm" sipas Rregullores Nr.12/2015 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit është pengesë për avancim, deri në Vlerësimin e prokurorit sipas Rregullores Nr.05/2020 për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve të Shtetit;
  - Të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore në pesë (5) vitet e fundit, përjashtimisht qortimit dhe vërejtjes jopublike;
  - Të mos ketë filluar hetimi penal;
  - Te ketë reputacion të lartë profesional;
  - Me rastin e avancimit do të merren parasysh pjesëmarrja në trajnime në fushën specifike që ndërlidhet me njohuritë e përgjithshme në procedurë penale, mjetet juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, përgatitja akademike, punimet shkencore, ligjërimiti në akademi apo nivel universitar, angazhimi i prokurorit në sistemin prokurorial dhe pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare në cilësinë e ekspertit dhe pjesëmarrja në ekiye hetuese.
2. Përveç kriterëve të përgjithshme kandidatët që aplikojnë për avancim duhet t'i plotësojnë edhe kriteret e veçanta si në vijim:

- Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë mandat të përhershëm si prokuror dhe vlerësim pozitiv të performancës.
3. Kandidatët që aplikojnë për avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit si dhe ti bashkëngjisin dokumentet si në vijim:
    - Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre (3) vitet e fundit;
    - Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
    - Dokumentet apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese të përbashkëta.
  4. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
  5. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 6 mars 2025 deri më 20 mars 2025.
  6. Kërkesa duhet të dorëzohet tek Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, z. Sami Istrefi, në katin e katërt (4), ndërtesa e Këshillit Prokurorial të Kosovës, Rruga “Luan Haradinaj”, Prishtinë, zyra numër 407, të mbyllura me zarf ose me postë.

-----

<sup>1</sup> Prokurorët të cilët aplikojnë për transferim dhe avancim duhet të plotësojnë formularin për Avancim dhe Transferim të Prokurorëve të Shtetit, të cilin mund ta gjejnë likun <https://www.prokuroria-rks.org/shpallje/183/332/> duke i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara me Rregullore.